



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo



Udhëzues për plotësimin e formularit online për pozitë:
Mbikëqyrës dhe Regjistruës
në projektin e
Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave
(REKOS 2023)

Prishtinë,
Shtator 2023


INFORMACIONI MBI APLIKIMIN PËR POZITAT:

1. Mbikëqyres dhe
2. Regjistruues

Si të aplikoni?

Gjeni linkun në faqen zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës (ASK), në institucionet tjera qeveritare dhe komunat tuaja: <https://rekosrekrutime.rks-gov.net> dhe do të hapet dritarja siç tregohet në figurën 1 më poshtë:

Figura 1. Dritarja e Aplikimit



Pasi të hapet dritarja sipas figurës më lartë, duhet të përcaktoni pozitën për të cilën dëshironi të aplikoni.

Pasi të keni përcaktuar, duhet të klikoni në pozitën që keni zgjedhur për aplikim. Ka gjithsej 9 fusha që duhet ti plotësoni, si dhe 5 dokumente që duhet ti ngarkoni/upload.

Fushat që duhet të plotësoni:

1. **Numri Personal Identifikues:** ju duhet të shkruani Numrin tuaj Personal Identifikues, i cili gjendet në leternjoftim, pasaportë, certifikate ose dokumente tjera zyrtare.
2. **Emri:** plotësohet automatikisht pasi të keni shënuar Numrin Personal Identifikues.
3. **Mbiemri:** plotësohet automatikisht pasi të keni shënuar Numrin Personal Identifikues.
4. **Datëlindja:** plotësohet automatikisht pasi të keni shënuar Numrin Personal Identifikues.
5. **Email:** ju duhet të plotësoni fushën duke dhënë e-mail adresën tuaj
6. **Telefoni:** ju duhet të shkruani numrin tuaj personal.
7. **Etniciteti:** ju duhet të shënoni përkatësinë tuaj etnike.
8. **Komuna (Në të cilën aplikoni për punë):** ju duhet të zgjidheni komunën në të cilën po aplikoni.
9. **Vendbanimi (Në të cilin aplikoni për punë):** duhet të zgjidheni vendbanimin për të cilin aplikoni. Kujdes, aplikuesit nga ky vendbanim kanë përparësi për pozitën e regjistruarit (për pozitën e regjistruarit).

Dokumentet që duhet ti ngarkoni (upload):

1. **Lejenjoftimi:** duhet të ngarkoni dy (2) anët e lejenjoftimit (për të verifikuar shtetësinë).
2. **Patentë shoferi:** duhet të ngarkoni dy (2) anët e patentës shoferi.
3. **CV (Rezume):** ngarkoni CV-në tuaj.
4. **Niveli më i lartë i arsimit tuaj:** ngarkoni diplomën ose certifikatën e arsimit tuaj të nivelit më të lartë të përfunduar.
5. **Dëshmi për përvojën e punës:** vërtetim ose referenca.

Shënim: Skedarët/Dokumentet duhet të ngarkohen në formatin: JPG/JPEG, .pdf dhe nuk duhet të kalojnë madhësinë 10 MB.